



05/04/2023

Gjirokastrë – Vihet Në Pranga 1 Shtetas, Për Armëmbajtje Pa Leje

Gjirokastrë/Kontrolle në ambiente të ndryshme, për goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje.

Mbante armë zjarri dhe municion luftarak, në banesë, vihet në pranga 25-vjeçari.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale, arma e zjarrit pushkë dhe 1 granatë dore.

Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar në inteligjencën policore se një shtetas mbante armë zjarri, në banesë, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë arrestuan në flagrancë shtetasin A. G., 25 vjeç, banues në fshatin Picar, Gjirokastrë.

Ky shtetas u arrestua në flagrancë pasi gjatë kontrollit të ushtruar nga shërbimet e Policisë, në banesën e tij, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri pushkë dhe 1 granatë dore.

Materialet procedurale në ngarkim të shtetasit A. G. i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit".



Kërko

Enter a word for search

Q



Arkiva

Select Month

- Linqe
- >

Arkiva
- >

Akademia e Sigurisë
- >

Ministria e Brendshme
- >

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- >

Interpol
- >

Europol
- >

Misioni PAMECA V
- >

SCPA
- >

Projekti Trivalent